

Përmbledhje

Performanca relativisht e mirë gjatë tremujorit të parë (TM1) të vitit 2013 u përcoll me trende të ngjashme edhe gjatë tremujorit të dytë (TM2). Në këtë kontekst, sektori fiskal vazhdoi zgjerimin e shpenzimeve duke vazhduar të ketë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Deficiti tregtar u ngushtua për 0.6 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo si rezultat i rritjes prej vetëm 0.6 përqind të importeve dhe rritjes prej 9.9 përqind të eksporteve. Të dhënat nga anketa e Odës Ekonomike të Kosovës me biznese kryesisht konfirmojnë se në TM2 2013 performanca e ndërmarrjeve në sektorin tregtisë ishte më e dobët se pritjet e ndërmarrësve. Ndërsa, trendet e përgjithshme janë në drejtim të rritjes së prodhimit vendor dhe zëvendësimit të produkteve të importuara me prodhime vendore. Performanca më e mirë e ekonomisë së Eurozonës gjatë gjysmës së parë të vitit është reflektuar pozitivisht në ekonominë e Kosovës përmes rritjes së dërgesave të emigrantëve. Po ashtu, vlera e investimeve të huaja direkte në Kosovës gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje. Sektori financiar i Kosovës ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar vazhduan të rriten, përderisa treguesit e qëndrueshmërisë vazhdojnë të paraqesin një gjendje të kënaqshme të shëndetit të këtij sistemi.

Ecuritë e çmimeve gjatë TM2 2013 ishin relativisht stabile duke arritur normë vjetore të inflacionit prej 2.7 përqind. Çmimet në Kosovë vazhdojnë të kenë prirje të ngjashme me çmimet e importit të cilat deri në mars 2013 u rritën me 2 përqind. Tregu i bonove të thesarit vazhdoi të karakterizohet me ofertim të lartë dhe me normë të ulët të interesit që reflekton stabilitetin financiar dhe fiskal në Kosovë.

Ngjarjet kryesore në tremujorin e dytë

Anketa mbi kreditimin bankar për TM2 2013 tregon për rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet.

Anketa për klimën e biznesit tregon për zhvillime pozitive në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve në TM2 2012.

Bilanci tregtar ka shënuar përmirësim të lehtë si rezultat i rritjes më të lartë të eksportit në krahasim me rritjen e importit.

Për tremujorin e tretë të vitit 2013, pritjet që burimet kryesore të financimit dhe konsumit në ekonominë e vendit të vazhdojnë të rriten. Bizneset në përgjithësi kanë raportuar pritje pozitive për sa i përket aktivitetit të përgjithshëm ekonomik dhe punësimit gjatë tremujorit të ardhshëm. Po ashtu, bankat komerciale kanë raportuar se pritjet rritje e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet gjatë tremujorit të tretë, mirëpo kriteret e bankave pritjet të mbesin të shtrënguara për sa i përket kreditimit të ndërmarrjeve.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE ----- i

Zhvillimet në ekonominë globale ----- 03

Ekonomia e Kosovës ----- 04

Sektori Real -----	04
Sektori Financiar -----	07
Kompanitë e Sigurimit -----	10
Fondet Pensionale -----	11
Institucionet Mikrofinanciare -----	11
Tregu i Bonove të Thesarit -----	11
Sektori Fiskal -----	11
Sektori i Jashtëm -----	12

GRAFIKËT DHE TABELAT ----- 03

Figura 1. Çmimi i naftës “brent crude” -----	03
Figura 2. Çmimet e metaleve -----	03
Figura 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit -----	04
Figura 4. Norma e këmbimit e euros -----	04
Figura 5. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e financimit e ECB-së -----	04
Figura 6. Vlerësimi i Bizneseve për situatën biznesore dhe pritjet për punësim -----	05
Figura 7. Zhvillimet në tre muajt e fundit sipas industrive -----	05
Figura 8. Pritjet për situatë biznesore në tre muajt e ardhshëm sipas industrisë -----	06
Figura 9. Indeksi i çmimeve të konsumit -----	06
Figura 10. Regjistri i bizneseve -----	06
Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja -----	07
Figura 12. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave -----	07
Figura 13. Vlera e kredive sipas veprimtarisë ekonomike -----	08
Figura 14. Mesatarja kuartale e normave të interesit -----	09
Figura 15. Normat mesatare kuartale të interesit për kredi për ndërmarrjet -----	09
Figura 16. Treguesit e profitabilitetit -----	10
Figura 17. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë -----	10
Figura 18. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë -----	11
Figura 19. Importet eksportet dhe bilanci tregtar -----	12

Figura 20. Pranimet e dërgesave të emigrantëve	12
Figura 21. Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik	13
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik	14

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl. Swich Franc: CHF</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>)
ECB	Banka Qendrore Evropiane (<i>angl: European Central Bank: ECB</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>)
GBP	Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>)
IHD	Investimet e Huaja Direkte (<i>angl. Foreign Direct Investments: FDI</i>)
IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar (<i>angl. International Monetary Fund: IMF</i>)
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit (<i>angl: Imports Price index: IPI</i>)
NPL	Kredive Jopërformuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>)
NREK	Norma Reale Efektive e Këmbimit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
PPI	Indeksi i Çmimit të Prodhimit (<i>angl. Producer Price Index: PPI</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>)
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
USD	Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>)

Zhvillimet në Ekonominë Globale


Shenjat e rimëkëmbjes që u shfaqën gjatë TM1 2013 në ekonominë globale filluan të zbehen gjatë TM2 2013 nga rënia e konsiderueshme e kërkesës së brendshme në disa nga vendet e mëdha në zhvillim. Rrjedhimisht, edhe parashikimet për rritjen e ekonomisë globale për vitin 2013 janë reviduar në rreth 3 përqind nga 3.3 përqind sa kanë qenë në Prill 2013 (FMN, WOE 2013). Gjithashtu, si rrjedhojë e ngadalsimit të kërkesës së brendshme, vendet në zhvillim pritet të shënojnë normë më të ulët të rritjes krahasuar me vitin paraprak pasi që në TM2 2013 janë shfaqur edhe shenjat e para të ngadalsimit të aktivitetit kreditor si rezultat i shtrëngimeve të kritereve të kreditimit në sistemet financiare të këtyre vendeve.

Në anën tjetër, përkundër zhvillimeve më të ngadalshme në vendet në zhvillim, ekonomia e SHBA-ve u rritë më shumë se që ishte parashikuar, duke sugjeruar se efektet e kërkesës së jashtme por edhe shtrëngimeve fiskale janë tejkaluar nga ekonomia e këtij vendi (IMF WOE, 2013; Bloomberg, 2013). Gjithashtu, Eurostat ka vlerësuar se në TM2 2013 eurozona ka shënuar rritje prej 0.3 përqind krahasuar me TM1 2013, gjë që mund të ketë ngjallur shpresat për rritje edhe në pjesën tjetër të vitit, përkundër faktit se parashikimet fillestare patën paraparë se ekonomia e eurozonës do të karakterizohet me rënie në vitin 2013.

Inflacioni vlerësohet të ketë shënuar rënie në TM2 2013. Sipas vlerësimeve të Eurostat-it, inflacioni në eurozonë shënoi rënie nga 1.9 përqind sa ishte në TM1 2013 në 1.4 përqind në TM2 2013. Edhe në

SHBA ishte nivel pothuajse i njëjtë i shkallës së rënies së inflacionit, nga 1.6 përqind në TM1 2013 në 1.2 përqind në TM2 2013. Çmimet e naftës ('brent crude')¹ në TM2 2013 shënuan rënie për rreth 8 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, që është një indikacion i rënies së kërkesës globale për këtë produkt (Figura 1).


Figura 1. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: Bloomberg (2013)

Përveç çmimeve të naftës, rënie shënuan edhe çmimet e metaleve të cilat në TM2 2013 ishin për 6 deri 9 përqind më të ulëta në krahasim me TM2 2012 (Figura 2).

Figura 2. Çmimet e metaleve, në USD për ton




Burimi: Bloomberg (2013)

Rënia e çmimeve të produkteve kryesore në tregjet

¹ 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

globale u pasua edhe me rënie të çmimeve të produkteve ushqimore. Krahasimi vjetor i çmimeve të produkteve ushqimore tregon se deri në TM2 2013 çmimet e produkteve ushqimore në nivel global ishin më të ulëta për 2.5 përqind. Rënie më e theksuar u shënua te çmimet e drithërave të cilat në TM2 2013 ishin për 7.3 përqind më të ulëta se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 3).


Figura 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAUN (2013)

Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore botërore konsiderohet se ka qenë stabile,

Figura 4. Norma e këmbimit e Euros




Burimi: BQK (2013)

duke pasur lëvizje shumë të lehtë vetëm kundrejt dollarit amerikan i cili u zhvlerësua në fund të TM2 2013 krahasuar me TM1 2013 (Figura 4).

Në maj të vitit 2013 norma bazë e rifinancimit e Bankës Qendrore Evropiane (*angl. European Central Bank: ECB*) u zvogëlua nga 0.75 në 0.5 përqind me qëllim që të lehtësohet qasja në financa për sistemin bankar evropian. Norma bazë e rifinancimit ka arritur nivelin më të ulët historik në eurozonë. Kjo masë erdhi si rezultat i të dhënave jo të favorshme sa i përket nivelit të papunësisë si dhe inflacionit më të ulët se sa niveli i targetuar. Si rezultat i likuiditetit të mjaftueshëm, norma Euribor gjatë kësaj periudhe u karakterizua me rënie të lehtë. Normat 1-mujore nuk patën ndryshime gjatë TM2 2013; 3-mujore shënuan rënie të lehtë; 6-mujore dhe 12-mujore u karakterizuan me rënie nga mesatarisht 0.35 përkatësisht 0.57 në 0.31 përkatësisht 0.51 përqind (Figura 5).

Figura 5. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2013) dhe ECB (2013)

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Të dhënat zyrtare të publikuara nga ASK-ja tregojnë se ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2012 shënoi një normë reale të rritje prej 2.5 përqind, ndërsa nga të


dhënat preliminare vërehet se performanca e disa indikatorëve gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 ka qenë më e mirë dhe rrjedhimisht, viti 2013 pritët të ketë normë edhe më të lartë të rritjes. Përmirësimet në sektorin e jashtëm, si investimet e huaja direkte, dërgesat e emigrantëve si dhe eksportet tregojnë për aktivitet të shtuar në ekonominë e vendit. Edhe të dhënat e sektorit real si numri i bizneseve të reja dhe vlerësimet e biznesit për klimën afariste japin indikacione për një aktivitet më të madh në ekonominë e vendit.

Që nga TM1 2013, Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka filluar të realizojë anketën me biznese mbi klimën e biznesit në bazë tremujore. Kjo anketë është e ngjashme me anketat në bazë të të cilave përlllogaritet indeksi i besueshmërisë së bizneseve (*angl. business bondidence index, BCI*).² Anketa është realizuar me 363 biznese në TM1 2013 dhe me 438 biznese në TM2 2013. Pikëpamjet e shprehura në këtë anketë janë të bizneseve mbi perceptimin e tyre për aktivitetin e ekonomik dhe mbi pritjet e tyre për periudhat në vijim.

Siç edhe është paraqitur në figurën 6, vlerësimi i bizneseve për situatën biznese në TM2 2013 ka qenë më pozitiv se në TM1 2013, ndërsa pritjet e bizneseve për gjashtë muajt e ardhshëm të vitit 2013 janë mjaft optimiste që nënkupton se gjatë TM3 dhe TM4 2013 pritët të ketë përforsim të aktivitetit ekonomik në vend. Sa i përket punësimit, siç edhe

është paraqitur në figurën 6, pritjet janë se punësimi do të rritet gjatë TM3 2013.


Figura 6. Vlerësimi i bizneseve për situatën biznese dhe pritjet për punësim, indeks



Burimi: OEK (2013)

Në bazë sektoriale, performanca e vlerësuar nga vetë bizneset në TM2 është pozitive për sektorin e prodhimit dhe sektorin e shërbimeve, ndërsa sektori i ndërmarrjeve të tregtisë raportoi për performancë më të dobët (Figura 7).

Figura 7. Zhvillimet në 3 muajt e fundit sipas industrive, indeks



Burimi: OEK (2013)

Pritjet për 3 mujorin e ardhshëm janë mjaft optimiste marrë parasysh se vlera e indeksit tejkalon mbi 70 për secilin sektor, ndërsa siç edhe është paraqitur në figurën 8, sektori i prodhimit mban nivelin më të lartë pritjeve për TM3 2013. Gjithashtu, për periudhën e gjashtë muajve të ardhshëm, aktiviteti i përgjithshëm ekonomik shihet me optimizën nga ndërmarrjet dhe


²Kalkulimi i BCI-së është si në vazhdim:

$$BCI = (P * 1) + (A * 0.5) + (N * 0)$$

ku P paraqet përgjigjet pozitive, A paraqet përgjigjet neutrale ndërsa N paraqet përgjigjet negative. Në këtë kontekst, kur rezultati i indeksit merr vlerën 50 situata e përgjithshme është e pandryshuar. Kur vlera e indeksit është më e ulët se 50 situata konsiderohet negative, ndërsa kur indeksi tejkalon vlerën 50 situata konsiderohet pozitive.

është sektori i prodhimit që ka pritjet më optimiste (Figura 8).

Figura 8. Pritjet për situatë biznesore në 3 muajt e ardhshëm sipas industrisë, indeks




Burimi: OEK (2013)

Çmimet në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (*angl. Consumer Price Index: CPI*), gjatë TM2 2013 u karakterizuan me inflacion të moderuar. Rritja vjetore e çmimeve në TM2 2013 ishte 2.4 përqind, ndërsa krahasuar me TM1 2013, çmimet ishin më të ulëta për 0.5 pp (Figura 9). Niveli i çmimeve të konsumit në vend është i ndikuar mjaft nga çmimet e importeve gjë që reflektohet edhe nëpërmjet indeksit të çmimeve të importit (*angl. Import Price Index: IPI*). Mesatarja vjetore e IPI-së deri në TM2 2013 ka pasur sjellje mjaft të ngjashme me CPI-në, duke u rritur për 2.8 përqind.

Ndërsa, sa i përket çmimeve të prodhimit (*angl. Producer Price Index: PPI*), ndryshimi i mesatares vjetore deri në TM2 2013 ishte relativisht i lartë me 4.9 përqind. Kjo rritje ishte e nxitur nga rritja e peshës së mineraleve metalike që aktualisht përbëjnë 14.9 përqind të gjithëj indeksit të prodhuesit në vend (5 përqind në 2012) si dhe rritjes së çmimeve të mineraleve metalike për 17.9 përqind në mesatare vjetore. Rritja e peshës së kësaj kategorie ka ardhur si

rezultat i rritjes së përgjithshme të prodhimit të mineraleve metalike.


Figura 9. Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor



Burimi: ASK (2013)

Zhvillimet globale të çmimeve u reflektuan lehtë në normën reale efektive të këmbimit (NREK) të Euros në Kosovë kundrejt valutave të partnerëve tregtar. Në TM2 2013, NREK u devalvua për 1.1 përqind krahasuar me TM1 2013, ndërsa krahasuar me TM2 2012, NREK mbeti në nivel të ngjashëm.

Figura 10. Regjistri i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2013)

Gjatë TM2 2013 u regjistruan 2504 biznese të reja ndërsa u mbyllën 355 biznese (Figura 10). Numri i bizneseve të regjistruara është më i ulët se në TM1 2013, tremujor ky i cili ka pasur nivelin më të lartë për sa i përket numrit të bizneseve të reja të regjistruara (gjithëj 3101 biznese të reja).

Sa i përket strukturës së ndërmarrjeve të reja, tregtia vazhdon të dominojë me 30 përqind të gjithë ndërmarrjeve të regjistruara gjatë TM2 2013, por se edhe aktivitetet tjera si patundshmëria, ndërtimtaria dhe bujqësia kanë mbajtur një përqindje të konsiderueshme në ndërmarrjet e reja të regjistruara (Figura 11).

Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2013)


Sektori Financiar

Sistemi Bankar

Aktiviteti i sistemit bankar në Kosovë vazhdoi të zgjerohet edhe gjatë TM2 të vitit 2013. Asetet e sistemit bankar arritën vlerën prej 2.8 miliard euro në qershor 2013, që paraqet një rritje vjetore prej 5.1 përqind.

Kreditë e sistemit bankar shënuan rritje vjetore prej 2.8 përqind në TM2 2013, duke arritë vlerën prej 1.83 miliardë euro. Kreditë për ndërmarrjet private dhe kreditë për ekonomitë familjare mbetën kontribuuesit kryesor në rritjen e kredive gjatë kësaj periudhe (2.1 pp përkatësisht 1.3 pp në qershor 2013).

Figura 12. Trendi i rritjes së depozitave dhe kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Sidoqoftë, nga figura 12 mund të vërehet se norma vjetore e rritjes së gjithë kredive të sistemit bankar është karakterizuar me një trend rënës. Kreditë për ndërmarrje, që njëherit dominojnë strukturën e gjithë kredive me një pjesëmarrje prej 68 përqind, shënuan rritje vjetore prej 3.1 përqind në TM2 2013, krahasuar me rritjen vjetore prej 6.9 përqind në TM2 2012. Gjithashtu, me një pjesëmarrje prej 31 përqind në gjithë kreditë e sistemit bankar, kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 4.4 përqind në qershor 2013 (11.7 përqind në qershor 2012). Në baza kuartale, në TM2 2013 kreditë shënuan rritje prej 2.4 përqind, një përmirësim i ritmit të rritjes krahasuar me TM1 2013 kur kreditë u rritën me 1.1 përqind.

Zhvillimet pozitive kuartale në ritmin e rritjes së kreditimit mbështeten edhe nga rezultatet e anketës së kreditimit bankar që BQK realizon me bankat komerciale në vend në baza kuartale. Bankat deklaruan se gjatë TM2 2013, krahasuar me TM1 2013, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare është rritur. Sa i përket standardeve dhe kritereve të aplikuara në kreditim, bankat deklaruan se gjatë TM2 2013 kanë shtrënguar


kriteret për ndërmarrjet, më specifiku për ndërmarrjet e mëdha dhe kreditë afatgjata. Për sa i përket pritjeve për TM3 2013, kriteret për kreditë e ndërmarrjeve (veçanërisht për ndërmarrjet e mëdha) pritet të mbesin të shtrënguara, përderisa kërkesa për kredi nga ndërmarrjet pritet të rritet. Pritjet për rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet janë në linjë edhe me pritjet e vetë ndërmarrjeve për shtim të aktivitetit gjatë TM3 2013. Kërkesa pritet të rritet edhe për kreditë e ekonomive familjare për të cilat pritet edhe lehtësim i kriterëve të kreditimit nga bankat.

Struktura e kredive vazhdon të jetë e ngjashme, me kreditë për tregti që dominojnë strukturën e gjithsej kredive për ndërmarrjet me 53.2 përqind. Si pasojë e ngadalësimit të kreditimit të sistemit bankar në përgjithësi, si dhe ngadalësimit të aktivitetit të ndërmarrjeve tregtare, norma vjetore e rritjes së kredive për tregti ishte 3.7 përqind krahasuar me normën e rritjes vjetore prej 7.7 përqind në qershor 2012. Ngadalësimi i aktivitetit të ndërmarrjeve tregtare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013, reflektuar edhe përmes ngadalësimit të importit në këtë periudhë, u theksua edhe nga Anketa për Klimën e Biznesit në Kosovë të përpiluar nga OEK. Sipas anketës, bizneset në sektorin e tregtisë janë më pak të kënaqura me rreth 44 përqind të ndërmarrjeve tregtare të anketuara që kanë deklaruar se zhvillimi i biznesit të tyre gjatë TM2 2013, krahasuar me TM1 2013, ka shënuar rënie. Përkitazi, edhe pritjet në gjashtë muajt e ardhshëm për bizneset e sektorit të tregtisë mbesin më të ulëta.

Krahasuar me TM2 2012, kreditimi për sektorët e prodhimit dhe ndërtimit në TM2 2013 ishte

më i ulët (Figura 13). Kreditë për sektorin e prodhimit shënuan rënie prej 5.1 përqind, përderisa kreditë për ndërtimin shënuan rënie prej 1.2 përqind. Në anën tjetër, kreditimi i sektorit të bujqësisë u karakterizua me zhvillime pozitive në këtë periudhë, duke shënuar rritje vjetore prej 11.9 përqind në qershor 2013.

Figura 13. Vlera e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në milionë euro




Burimi: BQK (2013)

Duke arritur vlerën prej 2.2 miliard euro, gjithsej depozitat në sistemin bankar kanë shënuar rritje vjetore prej 4.4 përqind (7.7 përqind në qershor 2012). Kontribues kryesor në rritjen e gjithsej depozitave të sistemit bankar vazhduan të jenë depozitat e ekonomive familjare. Sa i përket depozitave të ndërmarrjeve, në qershor 2013 është vënë re një normë më e ulët e rritjes të depozitave të ndërmarrjeve private, përderisa depozitat e institucioneve financiare u zvogëluan kryesisht si pasojë e zvogëlimit të depozitave të fondeve pensionale.

Mesatarja kuartale e normës efektive të interesit në kredi vazhdoi trendin rënës. Në TM2 2013, norma mesatare kuartale e interesit në kredi ishte 12.3 përqind krahasuar me 13.5 përqind në TM2 2012 (Figura 14).

Figura 14. Mesatarja kuartale e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


Rënia e normës së interesit në kredi në TM2 2013 është rezultat i rënies së normës së interesit në pothuajse të gjitha kategoritë e kredive. Kreditë e sektorit bankar për ndërmarrjet private, si kreditë për investime ashtu edhe kreditë tjera biznesore kishin normë më të ulët të rritjes në TM2 2013 krahasuar me TM2 2012 (Figura 15).

Përrjashtim bëjnë kreditë për blerje të shtëpive, të cilat në TM2 2013 kanë shënuar rritje vjetore prej 1.6 pikë përqindje. Norma mesatare kuartale e interesit në depozita mbeti e përafërt, duke zbritur në 3.5 përqind në TM2 2013 nga 3.6 sa ishte në TM2 2012 (Figura 15). Rrjedhimisht dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita u zvogëluar, duke zbritur në 8.8 përqind nga 9.9 përqind sa ishte në TM2 2012.

Performanca e sistemit bankar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 ishte pozitive, ku fitimi neto i sistemit arriti vlerën 16.2 milionë, që tregon për një rritje prej 5.6 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Përderisa të hyrat e sistemit bankar kanë shënuar rënie të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, shpenzimet kanë pësuar rënie më të theksuar dhe kjo kryesisht për

shkak të shpenzimeve më të ulëta në kategorinë e shpenzimeve për provizione (19.9 milion euro në TM2 2013 krahasuar me 27.5 milion euro në TM2 2012).

Figura 15. Normat mesatare kuartale të interesit për kredi për ndërmarrjet, në përqindje




Burimi: BQK (2013)

Deri në qershor 2013, norma e Kthimit në Mesataren e Aseteve (ROAA)³ është përmirësuar në 1.2 përqind nga 0.7 përqind në dhjetor 2012. Edhe norma e Kthimit në Mesataren e Kapitalit (ROAE) është rritur në 11.7 përqind, nga 7.1 përqind sa ishte në dhjetor 2012 (Figura 16). Gjithashtu, në qershor 2013 është përmirësuar raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sistemit bankar, indikator ky që zbriti në 86 përqind nga 90.5 përqind në dhjetor 2012, gjë që flet për përmirësim të efikasitetit.

Në qershor 2013, kreditë joperformuese kishin një pjesëmarrje prej 7.6 përqind në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Vlen të theksohet se pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë mbeti e pandryshuar nga muaji mars kur poashtu qëndronte në 7.6 përqind, përderisa krahasuar me dhjetor 2012 shënoi një rritje prej 0.1 pikë përqindje (Figura 17).

³ Treguesit ROAA dhe ROAE janë të aktualizuar.


Figura 16. Treguesit e profitabilitetit



*Profiti i anualizuar i tremujorit të dytë
Burimi: BQK (2013)

Sektorët që kontribuan në rritjen e kredive joperformuese gjatë kësaj periudhe ishin kryesisht prodhimitaria, tregtia dhe kreditë për individët dhe ekonomitë familjare. Kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë. Në qershor 2013, mbulueshmeria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë është rritur në 113.8 përqind, krahasuar me 111.9 përqind në dhjetor 2012.

Figura 17. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë



Burimi: BQK (2013)

Niveli i kapitalizimit të sistemit bankar vazhdoi të qëndrojë në nivel të kënaqshëm. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) në qershor 2013

arriti në 16.6 përqind⁴ nga 15.1 për qind sa ishte në mars 2013 dhe 14.4 përqind në dhjetor 2012 (minimumi i kërkuar nga BQK është 12 përqind). Përforcimi i kapitalizimit të sistemit i atribuohet kryesisht përmirësimit të fitimit të sistemit bankar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013.

Pozita e likuiditetit të sistemit bankar në TM2 2013 vazhdon të jetë e qëndrueshme. Raporti i kredive ndaj depozitave në TM2 2013 arriti në 82.9 përqind, nga 78.6 përqind në mars 2013 dhe 77.4 në dhjetor 2012. Gjithashtu, raporti i aseteve të gjera likuide (*ang: broad liquid assets*) ndaj gjithsej aseteve qëndroi në 29.3 përqind në TM2 2013 (31.1 përqind në mars 2013 dhe 32.6 përqind në dhjetor 2012). Indikator tjetër i rëndësishëm i likuiditetit është raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra, që në qershor 2013 ishte 38.5 përqind, që paraqet një nivel më të lartë sa sa minimumi i kërkuar me rregullën përkatëse për menaxhimin e likuiditetit.

Kompanitë e sigurimit

Aktiviteti i industrisë së sigurimeve në Kosovë vazhdoi të zgjerohet edhe në TM2 2013, kur gjithsej asetet e kompanive të sigurimit arritën në 130.1 milion euro, një rritje vjetore prej 8.3 përqind. Vlera e primeve të kontraktuara në qershor 2013 arriti në 40.5 milion euro që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, paraqet një rritje vjetore prej 16.4 përqind. Gjithashtu, vlera e dëmeve të paguara shënoi një rritje vjetore prej 2.3 përqind, duke arritur vlerën prej 13 milion euro. Deri në qershor 2013, tregu i sigurimeve u karakterizua me humbje në vlerë prej

⁴Rezerva e kapitalit për rrezik operacional nuk është përfshirë në kalkulimin e CAR për TM2 2013, konform rregullores në fuqi të BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, të aprovuar me datën 10 maj 2013, e cila obligon bankat për përfshirjen e ngarkesës për rrezik operacional duke filluar nga muaji korrik 2013.

1.4 milion euro. Përderisa gjithsej të hyrat shënuan rritje prej 6 përqind në TM2 2013 krahasuar me TM2 2012, ishte rritja e gjithsej shpenzimeve administrative prej 24.7 përqind në TM2 2013 krahasuar me TM2 2012 që ndikoi në rënien e profitit të tregut të sigurimeve gjatë kësaj periudhe.

Fondet pensionale

Në qershor 2013, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) realizoi kthim pozitiv nga investimet në vlerë prej 17.1 milion euro. Në të njëjtën kohë, edhe vlera e çmimit të aksionit shënoi rritje vjetore prej 7 përqind duke arritur në 1.14 euro në qershor 2013. Rritja e vlerës së çmimit të aksionit ndikoi në rritjen e gjithsej mjeteve nën menaxhim të TKPK-së në 803 milion euro në qershor 2013, një rritje vjetore prej 22.8 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Institucionet mikrofinanciare

Aktiviteti i institucioneve mikrofinanciare është karakterizuar me rënie edhe në TM2 2013. Asetet e institucioneve mikrofinanciare shënuan vlerën prej 113 milion euro në qershor 2013, që paraqet një rënie vjetore prej 6.1 përqind. Kjo rënie është kryesisht pasojë e zvogëlimit të aktivitetit kredidhënës. Gjithsej kreditë e lëshuara nga IMF-të arritën vlerën prej 74.3 milionë euro në qershor 2013, që paraqet një rënie vjetore prej 10.1 përqind. Profiti rezultoi të jetë negativ prej 0.6 milion euro në TM2 2013, përkundër rritjes së normës mesatare të interesit në kreditë e IMF-ve nga 22.4 përqind në TM2 2012 në 24.8 përqind në TM2 2013.

Tregu i Bonove të Thesarit

Gjatë TM2 2013, konform kalendarit të publikuar, u shpallën pesë ankande për letra me vlerë, nga të cilat tre për periudhë maturimi 91 ditë, një për periudhë maturimi 182 ditë dhe, për herë të parë, një për afat maturimi 364 ditë. Siç edhe është paraqitur në figurën 18, ofertimi ka vazhduar të jetë afër 2 herë më i lartë se sa shumat e kërkuar, ndërsa norma vjetore e interesit për shumat 10 milionë euro ka vazhduar të jetë rreth 0.5 përqind.

Figura 18. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë, në milionë euro



Vërejtje: Ankandet janë për shumën e ofertuar për 91 ditë.
Burimi: BQK (2013)

Ndërsa, në ankandin për shumën e 20 milionë eurove, me afat maturimi 182 ditë, ofertimi ishte 1.5 herë më i lartë dhe norma vjetore e interesit ishte në 0.94 përqind. Normë më e lartë e interesit u regjistrua në ankandin për 20 milion euro me afat maturimi prej 364 ditë, e cila arriti në 2.26 përqind.

Sektori Fiskal


Zhvillime pozitive gjatë kësaj periudhe vlerësohet të ketë pasur edhe në sektorin fiskal. Vlora e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore deri në fund të qershorit 2013 arriti në 626.3 milionë euro që paraqet një ngritje të lehtë prej 0.1 përqind krahasuar me

periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në anën tjetër, të hyrat buxhetore shënuan rritje vjetore prej 3.9 përqind duke arritur vlerën prej 674.8 milionë euro.

Sektori i Jashtëm

Deficiti i llogarisë rrjedhëse në TM1 2013 ishte 13.4 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 35.8 përqind. Deficiti i llogarisë rrjedhëse si shkaktar kryesor ka deficitin tregtar i cili arriti në 984.5 milion euro deri në qershor 2013. Sidqofotë, si rezultat i rritjes së eksporteve për 9.9 përqind dhe rritjes së importeve prej vetëm 0.6 përqind, deficitin tregtar ka shënuar rënie vjetore prej 0.6 përqind (Figura 19). Deri në qershor 2013, gjithsej eksportet arritën vlerën prej 148.8 milion euro, përderisa importet arritën vlerën prej 1.1 miliard euro.

Figura 19. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative




Burimi: ASK (2013)

Rritja e ngadalshme e importeve më së shumti mund ti adresohet rënies së çmimeve të naftës pasi që në terma nominal importi i produkteve minerale (pjesa kryesore e produkteve minerale janë derivate të naftës) shënoi rënie për 14.1 përqind, dhe njëherit është kategoria me pjesmarrje më të madhe në gjithsej importet. Përkundër këtyre zhvillimeve, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte

mbetet në 13.1 përqind, që reflekton bazën e ulët të eksporteve.⁵

Për dallim nga TM1 2012 kur kishin shënuar rënie, dërgesat e emigrantëve në fund të TM1 2013 arritën vlerën prej 127.8 milion euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.3 përqind, gjë e cila i kontribuon rritjes së konsumit në ekonominë e vendit dhe paraqet një kontribut të rëndësishëm për ngushtimin e deficitit në llogarinë rrjedhëse (Figura 20).

Figura 20. Pranimet e dërgesave të emigrantëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


Përveç dërgesave të emigrantëve, edhe të hyrat nga kompensimi i punonjësve sezonal kanë kontribuar në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Gjithashtu, bilanci pozitiv në kuadër të eksportit të shërbimeve është përmirësuar edhe më tutje duke arritur në 59.5 milionë euro. Kjo kategori dominohet nga shërbimet e udhëtimit dhe kryesisht paraqesin shpenzimet e diasporës në Kosovë.

Gjatë TM1 2013, vlera e IHD-ve arriti në 60.1 milionë euro, që paraqet rritje prej 6.9 përqind krahasuar me TM1 2012. Investimet e huaja direkte konsiderohet se kanë lidhshmëri të lartë me zhvillimet e përgjithshme

⁵ Të dhënat e tregtisë për periudhën shtator 2012 deri në janar 2013, të përpiluara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, nuk përfshijnë eksportin dhe importin e Energjisë Elektrike.

ekonomike në vendet e eurozonës marrë parasysh se pikërisht këto vende paraqesin burimin kryesor të IHD-ve.

Figura 21. Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik



Struktura e investimeve të huaja direkte në TM1 2013 është karakterizuar me rritjen e mëtutjeshme të pjesëmarrjes së sektorit të patundshmërive (37.6 përqind e gjithsej IHD-ve), ndërsa sektorët si prodhimi dhe agrikultura kanë pësuar rënie të lehtë (Figura 21).

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Qershor 2013
Sektori real 1/							
PBB (në milionë euro)	3,379.4	3,710.7	4,077.0	4,136.5	4,486.0	5,021.0	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	4.4%	9.4%	-2.4%	3.5%	7.3%	2.5%	2.7%
Çmimet (ndryshimi vjetor)	10.5%	0.5%	0.1%	6.6%	3.6%	3.7%	2.7%
Sektori fiskal 2/							
Të hyrat (në milionë euro)	903.0	943.0	1,147.0	1,179.0	1,303.3	1,538.0	674.8
Shpenzimet (në milionë euro)	662.0	951.0	1,233.0	1,272.0	1,388.0	1,466.5	626.3
Bilanci, si përqindje e PBB-së	7.1	(0.2)	(2.1)	(2.2)	(1.9)	(1.4)	48.6
Sektori financiar (në milionë euro) 3/							
Asetet e korporatave financiare	2,941.9	3,370.3	4,005.0	4,440.5	4,732.0	5,289.3	5,321.3
prej të cilave: Bankat	1,435.0	1,808.3	2,204.6	2,455.0	2,649.7	2,829.3	2,787.0
Kredi	892.1	1,183.4	1,289.0	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,825.7
Depozita	1,143.1	1,444.1	1,744.8	1,936.9	2,104.0	2,279.1	2,201.3
Norma e interesit në kredi	14.1	13.8	14.1	14.3	13.9	12.9	12.0
Norma e interesit në depozita	4.0	4.4	4.0	3.4	3.6	3.7	3.5
Hendeku i normës së interesit	10.1	9.4	10.1	10.9	10.2	9.1	8.5
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/							
Bilanci i pagesave							
Llogaria rrjedhëse	-214.0	-460.9	-374.2	-515.7	-658.5	-380.2	-13.4
prej të cilave: importi i mallrave	-1,530.1	-1,866.3	-1,828.9	-2,057.1	-2,383.9	-2,359.7	-460.9
prej të cilave: dërgesat e emigrantëve	588.5	608.7	585.7	584.3	584.8	605.1	127.8
Llogaria financiare	-5.8	288.5	109.0	275.9	376.8	130.3	-8.4
Investimet e huaj direkte në Kosovë	440.7	366.5	287.4	365.8	393.9	229.1	60.1
Investimet portfolio, net	-34.5	-109.9	-124.4	-49.2	-57.0	-184.9	-53.5
Invetimet tjera, net	-108.0	75.2	-138.3	47.4	-5.6	369.2	-18.3
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net	1,278.9	941.2	524.4	444.6	133.9	248.8	405.9
Asetet	2,397.6	2,536.0	2,812.1	3,249.4	3,325.1	3,705.1	3,847.4
Detyrimet	1,118.6	1,594.9	2,287.8	2,804.8	3,191.2	3,456.3	3,441.4
Borgji i jashtëm, gjithsej	496.3	706.8	1,146.4	1,348.3	1,426.8	1,517.6	1,450.1
Borgji i jashtëm privat	496.3	706.8	837.1	1,022.4	1,106.7	1,116.2	1,052.2
Borgji i jashtëm publik	n/a	n/a	309.3	325.9	320.0	401.4	398.0

Burimi:

1/ ASK (2013).

2/ MF (2013).

3/ BQK (2013) - të dhënat për vitin 2013 janë deri në mars.

